



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

MAJ 2026

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigjia	Statusi	Pagesa
1.	30.04.2026	<p>Pas incidentit të fundit, ku fasada termoizoluese e objektit që u përfshi nga zjarri, u evidentua qartë një rrezik serioz për jetën dhe pronën tonë. Materialet e përdorura në fasadë rezultojnë potencialisht të rrezikshme në rast zjarri, duke favorizuar përhapjen e flakëve në mënyrë të shpejtë dhe të pa kontrollueshme. Kërkesat tona janë si më poshtë: 1-rrikthimi i aparatamenteve në gjendjen e mëparshme, sipas përmbajtjes së kontratës.</p> <p>2-sigurimi i strehimit dhe mbulilmi i shpenzimeve të qirasë për banorët, apartamentet e të cilëve janë dëmtuar/djegur.</p>	13.05.2026	Pas shqyrtimit të petitionit dhe kërkesave të paraqitura nga banorët, të cilat lidhen me sigurinë ndaj rrezikut nga zjarri, materialet termoizoluese si dhe çështje të tjera të natyrës teknike dhe ndërtimore, konstatohet se këto nuk bëjnë pjesë në fushën e përgjegjësisë së AKM-së pasi nuk ka kompetenca mbi vlerësimin dhe analizimin e materialeve të përdorura në ndërtim.	Përfunduar	Nuk ka

		<p>3-ekspertizë e pavaruar dhe e detajuar teknike për të vlerësuar sigurinë e materialeve termoizoluese të përdorura në fasadë.</p> <p>4-zëvendësimi i menjëhershëm i cdo materiali të rrezikshëm me material të certifikuar dhe rezistente ndaj zjarrit sipas standarteve evropiane.</p> <p>5-audit i plotë i sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit</p> <p>6-transparaencë nga kompania ndërtuese për materialet e përdorura dhe kontrollin e cilësisë gjatë ndërtimit</p> <p>7-përgjegjësi ligjore dhe administrative nëse konstatohet neglizhencë apo shkelje e standartave të sigurisë.</p> <p>8-zhdëmtimi i të gjithë banorëve dhe bizneseve të dëmtuara</p> <p>9-formalizimi i kontratave të porosisë pranë noterit</p> <p>10-pajisja e kompleksit me hidrantë dhe sisteme fikse zjarri funksionale.</p>				
2.	30.04.2026	Përmbledhje të ndërhyrjeve që zbatohen në kuadër të projektit “Programi për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmit” në zonën Sarandë- Ksamil. Cilat janë segmentet konkrete që janë	04.05.2026	Ju bëjmë me dije se aplikimi për VNM bëhet në fazën e projekt-idesë. AKM nuk ka dijeni për pajisjen me leje ndërtimi, për fillimin e punimeve në terren apo për kontraktorët që do të kryejnë punimet në fazën e zbatimit të lejes.	Përfunduar	Nuk ka

		<p>aktualisht në proces zbatimi dhe në cilën fazë ndodhen? Projektin teknik të bypass-it të Ksamilit, gjurmën e saktë të tij, hartat e detajuara të ndërhyrjeve, dokumentacionin e VNM si dhe cdo leje apo miratim përkatës? A është projekti i bypass-it të Ksamilit i ndarë në segmente apo lote të vecanta zbatimi? Nëse po cilat janë këto segmente dhe çfarë ndërhyrjesh përfshin secili? Cilët janë kontraktorët e përfshirë në zbatimin e projektit dhe cilat pjesë e projektit mbulon secili? Përtej ndërhyrjeve të prezantuara publikisht në kuadër të zhvillimit urban dhe turistik, cilat janë ndërhyrjet e plota teknike që përfshin projekti i bypass-it të Ksamilit gjatë gjithë gjurmës së tij. A përfshin projekti i bypass-it segmente që kalojnë pranë apo përgjatë Liqenit të Butrintit? A përfshin projekti ndërhyrje në zona me prani ujore në jug të Sarandës? A janë parashikuar në projekt struktura që mundësojnë ruajtjen e rrjedhës natyore të ujit përgjatë gjurmës së bypass-it? A përfshin projekti struktura si ura, tombino, kanale kulluese apo kalime mbi zona ujore? A janë të gjitha ndërhyrjet që po kryhen aktualisht në terren pjesë e projektit të miratuar fillestar?</p>		<p>Bazuar në dokumentacionin në aplikim, lidhur me projektin “Rinovimi urban i Ksamilit”, rezulton se projekti është i ndarë në dy faza: - Faza 1 e projektit, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura; - Faza 2 e projektit, një pjesë e vogël e projektit e emërtuar në dokumentacion me nr.11 (Platforma) dhe pika me koordinata e emërtuar nr. 2, ndodhet në kufi në zonën e mbrojtur parku kombëtar (PK) “Butrint”. Informacion më të detajuara rreth kërkesës Tuaj vlerësojmë se duhet ti drejtoheni Bashkisë Sarandë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit si institucionet kompetente për menaxhimin e projektit. Subjekti “Bashkia Sarandë” në lidhje me procedurën paraprake të VNM-së, për “Rinovimi urban i Ksamilit” me vendndodhje Ksamil, Bashkia Sarandë. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka dhënë Vendim për VNM Paraprake Bashkëlidhur materiali i plotë i dosjes së aplikuar, dhe hartat e paraqitura ne aplikim.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		<p>A ka pasur ndryshime nga projekti fillestar gjatë fazës së zbatimit? Si monitorohet përputhshmëria e punimeve në terren me projektin e miratuar, dokumentacionin mjedisor dhe standartet e përcaktuara nga Banka Botërore? Si koordinohet zbatimi i segmenteve/loteve të ndryshme të projektit për të garantuar përputhshmëri me projektin e miratuar?</p>				
3.	05.05.2026	<p>Sa asgjësime ka kryer subjekti Gj**** nga Janari 2020 deri në Prill 2026? Cila ka qenë sasia përkatëse e asgjësuar për çdo procedurë? Në cilin vend/ambient janë kryer procedurat e asgjësimit? Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të përgjigjes nga ana juaj.</p>	19.05.2026	<p>Pas verifikimit në portalin unik “e-inspektimi” për periudhën Janar 2020 – Prill 2026, nuk rezulton që për subjektin Gj****, nga ana e AKM-së të jenë kryer procedura asgjësimi. Gjithashtu ju bëjme me dije se nga Tetori 2022 e në vazhdim janë kryer procedura asgjësimi të produkteve/mallrave sipas kërkesave të subjekteve dhe nga IKMT.</p>	Përfunduar	Nuk ka
4.	06.05.2026	<p>Brenda zonës së banuar të fshatit tonë po ngrihet, ndërtohet, me ritme të shpejta pa leje ose “me Leje” një pik Grumbullimi Demontimi Automjetesh të vjetra. 1) Po ndërton themele prej betoni dhe mure rrethues të cilat në vazhdimësi nga fitilat e hekurave që janë rreth 4-5m të larta duket që po përgatitet të bëhet godinë, një pjesë në</p>	08.05.2026	<p>Nga ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe nga Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve bëhet me dije si vijon: Në përgjigje të shkresës ju bëjmë me dije se: Për vijimin e verifikimit nëse disponohet leje mjedisi në këtë vendndodhje, është i nevojshëm identifikimi i subjektit me nr. NUIS (Numri Unik Identifikimit Subjektit). <i>Në lidhje me pikat 1,2,3,4</i></p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>tokë të tij dhe pjesa tjetër tokështet.</p> <p>2) Po Ndërton Themelet/Muret ngjitur me 2(Dy) Tubacionet e transportit të Karburanteve që Shkarkojnë/Ngarkojnë anijet në Det (Rrezik për Zonën).</p> <p>3) Ka mbuluar në të gjithë gjatësinë e pjesës që po rrethon të 2(Dy) Tubacionet e transportit të Karburantëve (duke kaluar automjetet mbi të, jashtë kushteve teknike Rrezik për Zonën)</p> <p>4) Po mbush me inerte të gjithë atë pjesë të tokës duke lëvizur kuotat e tokës duke u bërë shkas përmbytje të pronave të tjera përreth.</p> <p>5) Cili institucion i dha “leje” Ndërtimi dhe Mjedisore në atë zonë për Depozitim, Demontim të automjeteve? Ku, ajo zonë është e përcaktuar për Banim ose Ekoturizëm/ Agroturizëm/Turizëm Kulturor sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, të miratuar nga Bashkia Vlorë dhe KKT, me Vendim nr 4 dt 14/10/2020 .</p> <p>6) Ky aktivitet po kryhet 5m Largë nga kanali kryesor që është i lidhur me Lagunën e Nartës. Këto vajra dhe mbetje filtrojnë dhe do futen në Lagunë nëpërmjet këtij Kanali dhe do kemi (Katastrof Mjedisore).</p> <p>7) Çdo mbasdite djeg pjesët e kablllove dhe të tjera mbetje të automjeteve aty.</p>		<p>AKM-ja shqyrton aplikime të ardhura në sistemin e_Leje, në e_Albania ,në zbatim të Ligjit nr.10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisit” të ndryshuar, VKM 686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar. Agjencia Kombëtare e Mjedisit(AKM) nuk është institucioni kompetent për verifikimin e ndërtimeve pa leje.</p> <p>Në zbatim të Ligjit nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, Ligjin nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe Ligjin nr. 99/2024 “Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 568/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”. Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) kanë kompetencën për të verifikuar dhe ndërrhyrë ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje apo në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, si dhe në rastet e ndotjes nga burime lokale, në përputhje me VKM nr. 509/2025 dhe Urdhrin e Inspektoratit Qendror nr. 29/2023.</p> <p>Në këtë kuadër, kërkohet bashkërendim ndërmjet Bashkisë Vlore dhe strukturave inspektuese IMT/IKMT, të cilat duhet të ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore për kontrollin dhe ndëshkimin e çdo shkeljeje të konstatuar.</p> <p><i>Në lidhje me pikat 5,6,7,8</i></p> <p>Referuar kërkesës nga ana juaj për pajisjen me Leje Mjedisi, për aktivitetin "Grumbullimi demontimi automjetesh të vjetra, kërkohet emri i subjektit përkatës, ku AKM mund të kryejë verifikimet përkatëse nëse ky subjekt është i pajisur me lejet përkatëse, për kryerjen e veprimtarisë së sipërcituar.</p>		
--	--	---	--	---	--	--

		<p>8) Me këto veprime fshati i Nartës po kthehet në një fshat për depozitime mbetjesh dhe skrapit, dhe jo për zhvillimin e Turizmit, i cili është e ardhmja e vendit.</p> <p>9) Ju Lutemi të merni masa për Ndalimin/ Heqjen e këtij aktiviteti nga zona, përpara se të jetë vonë dhe me pasoja të pariparueshme për ambientin dhe Komunitetin e Nartës.</p> <p>10) Kemi besim në reagimin tuaj pozitiv, prandaj dhe nuk po e bëjmë mediatik rastin</p>				
5.	06.05.2026	<p>Në vijim të studimit të projektit paraprak me objekt: “Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore Ekzistuese Rrogozhinë – Vlorë dhe Lidhja me Aeroportin e Vlorës”, nga ju përcjellim bashkëlidhur shkresën zyrtare të përgatitur nga “Hekurudha Shqiptare” sh.a., në lidhje me organizimin e një takimi konsultues teknik, me përfaqësues të konsulentit “ILF Consulting Engineers Austria GmbH” dhe institucionet përkatëse.</p> <p>Takimi i propozuar synon diskutimin e aspekteve teknike, mjedisore dhe sociale të projektit, në kuadër të fazës përmbyllëse të procesit të konsultimit me grupet e interesit. Sa i përket zhvillimit të takimit në ambientet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është marrë konfirmimi nga ana e MIE për disponueshmërinë e</p>	07.05.2026	U konfirmua grupi i punës.	Përfunduar	Nuk ka

		sallës së takimit në datën 12.05.2026, ora 11:00.				
6.	08.05.2026	<p>Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është depozituar ankesa nga Qendra e Nismave Qytetare për Mbrojtjen e Mjedisit, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, ndaj Autoritetit Publik/Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Fier/Agjencia Kombëtare e Mjedisit (në vijim “Autoriteti Publik”).</p> <p>Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës datë 03.02.2026, depozituar nëpërmjet shërbimit postar, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me procesin e konsultimetë zhvilluar për rinovimin e lejes së kompanisë Albstar ?</p>	08.05.2026	<p>Në vijim të informacionit të kërkuar nga Shoqata Zharrëza pranë Zyrës së Komisionerit, Bashkëlidhur gjeni korrespondencën dhe kthimin e përgjigjes nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë për Qendrën e Nismave Qytetare për Mbrojtjen e Mjedisit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkresa Nr.194/1 Prot datë 18.02.2026 nga ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë • Dëgjesa me publikun/Formulari Tipi II 	Përfunduar	Nuk ka
7.	08.05.2026	<p>Sa asgjesime ka kryer subjekti R****-L*** nga Janari 2020 deri në Prill 2026 ?</p> <p>Lutemi të na saktësoni datën, muajin, vitin kur janë kryer procedurat e asgjesimit.</p>	19.05.2026	<p>Pas verifikimit në portalin unik e-inspektimi për periudhën Janar 2020-Prill 2026, rezulton se për subjektin R****- L*** nga ana e AKM-së janë kryer gjithësej 3 procedura asgjesimi.</p> <p>Gjithashtu ju bëjmë me dije se nga Tetori 2022 e në vazhdim janë kryer procedura asgjesimi të produkteve sipas kërkesave të subjekteve edhe nga Inspektoriati Kombëtar Mbrojtjes së Territorit.</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>Cila ka qenë sasia përkatëse e asgjësuar për çdo procedurë?</p> <p>Në cilin vend/ambient janë kryer procedurat e asgjësimit?</p>				
8.	13.05.2026	<p>Kërkojmë informacionin e mëposhtëm për subjektin "E*** OIL" SH.P.K</p> <p>Lutem të na vini në dispozicion një kopje të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme që ky subjekt ka depozituar pranë AKM-së si pjesë e Lejes së Mjedisit.</p> <p>Me cilin subjekt të licencuar për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme (Kodi i mbetjes: 13 07 03* - llumra nga depozitat) ka lidhur kontratë për vitet 2024-2026?</p> <p>Kërkoj kopje të Dokumenteve të Transferimit të Mbetjeve (DTSH) për subjektin, që vërtetojnë sasinë e llumrave të dorëzuar për asgjësim dhe destinacionin final të tyre për vitet 2024-2026."</p>	20.05.2026	<p>Nga verifikimi në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB subjekti i deklaruar nga ana juaj nuk disponon leje mjedisi për ndikim në mjedisi me kod III.1.</p> <p>Operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Në linkun e mëposhtëm verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis si dhe licencat e nënkategorisë III.2.B:</p> <p>https://qkb.gov.al/leje-licensa-autorizime/ ose https://old.qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/</p> <p>Bazuar në Ligjin Nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit Nr. 371, datë 11.6.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, Vendimit Nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar si dhe Urdhërit të Ministrisë me nr.135, datë 16.04.2015 për “Miratimin e mënyrës së administrimit të formatit të Regjistrit të transfertave individuale dhe të Regjistrit Kombëtar të Transfertave si dhe mënyrën e administrimit të tyre”,</p>	Përfunduar	Nuk ka

				Subjekti nuk është i pajisur me kod unik dhe si rrjedhojë nuk ka raportim pranë Sektorit të Informacionit, Statistikave Mjedisore dhe GIS në lidhje me transfertat individuale të mbetjeve.		
9.	20.05.2026	<p>1. A është kontrolluar subjekti “E** OIL” SH.P.K nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit apo nga strukturat inspektuese përgjegjëse për çështjet mjedisore?</p> <p>2. A është konstatuar nga AKM mungesa e Lejes Mjedisore apo mungesa e regjistrimit me kod unik për raportimin e transfertave të mbetjeve për këtë subjekt?</p> <p>3. A janë marrë masa administrative ndaj subjektit “E** OIL” SH.P.K në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> · menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme; · mungesën e raportimit; · mungesën e dokumentacionit për transferimin e mbetjeve; 	20.05.2026	<p>Në vijim të informacionit të kërkuar, subjekti në fjalë nuk disponon leje mjedisi apo kod unik.</p> <p>AKM ushtron veprimtarinë e saj inspektuese në përputhje me Ligjin Nr.99/2024 “Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, të përditësuar, si dhe VKM Nr. 568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.</p> <p>Referuar kuadrit ligjor në fuqi, AKM ushtron funksione inspektuese vetëm ndaj operatorëve ekonomikë të pajisur me Leje Mjedisore të tipit A dhe B.</p> <p>Në zbatim të diskrecionit administrativ dhe kompetencës lëndore si dhe Urdhërit të Inspektoriatit Qendror Nr. 29, datë 30.08.2023, pikat 2 dhe 3, për “Zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushën e veprimtarisë inspektuese të mjedisit për IKMT dhe AKM”, percakton se</p> <p>2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të ushtrrojë veprimtarinë në fushën e përgjegjësisë shtetërore, vetëm për rastet e inspektimit të përputhshmërisë të aktivitetit të operatorëve me kushtet/kriteret e përcaktuara në Lejet Mjedisore.</p> <p>3. Trupa inspektuese e IKMT, kur konstaton se operatori me Leje Mjedisore ka thyer kushtet e lejes mjedisore, të njoftojë pa vonesë Inspektoratin Qendror edhe për kompetencë Inspektoratin e AKM-së, reciprokisht inspektorët e AKM-së, nëse marrin indicie, apo konstatojnë në flagrancë aktivitet mjedisor pa leje mjedisore, të njoftojnë Inspektoratin Qendror edhe Inspektoratin e IKMT-së, për kompetencë.</p>	Përfunduar	Nuk ka
10.	28.05.2026	Në lidhje me aplikimin e subjektit K**** E***** Shqiptare Sh.a, aplikimi në	28.05.2026	Referuar kërkesës për informacion në lidhje me subjektin “K**** E***** Shqiptare” sh.a për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin	Përfunduar	Nuk ka

		lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hydrocentrali i Skavicës” me vendndodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjekti e cila është		“Hydrocentrali Skavicës” me vendndodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjekti nuk ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së të thelluar.		
--	--	---	--	--	--	--